

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZAE POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vlerësim i gjithëpërfshirjes për rikuperimin e aseteve në Shqipëri, Nëntor 2018, Projekti IPA/2017
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	08.02.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	5 Shkurt 2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	PO, 13.02.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 - MFE-04
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Sokol Shehu Sokol.Shehu@aapsk.gov.al Musa Hyka Musa.Hyka@aapsk.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJEEKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë“</i> Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr .503, datë 30.6.2005, “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, të ndryshuar. Aktualisht AAPSK-ja has vështirësi për kryerjen e misionit të saj me efektshmëri të lartë. Si shkak kryesor për këtë është mungesa e parashikimit me ligj që Gjykatat e Rretheve Gjyqësore i kalojnë për administrim AAPSK-së, pasuritë që sekuestrohen/konfiskohen gjatë proceseve gjyqësore që ata zhvillojnë. Sipas Vlerësimit të 4-t të MONEYVAL dhe Planit për zbatimin e rekomandimeve të lëna pas këtij vlerësimi, është evidentuar nevoja për fuqizimin e AAPSK-së, nëpërmjet shtimit të kompetencave së saj, duke përfshirë në rolin e saj, administrimin e të gjitha pasurive me prejardhje kriminale. Në këto rrethana del e nevojshme ndërhyrja e qeverisë për të fuqizuar rolin e AAPSK-së dhe parashikimin në rang ligjor të kompetencave të saj, por edhe të detyrimeve të	

subjekteve të tjerë ndaj saj”.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

1. Të krijohen mekanizmat ligjore për të menaxhuar në mënyrë efektive pasuritë e ngrira dhe të konfiskuara, në pritje të një vendimi të formës së prerë. (UNCAC, neni 60, Konventa e Varshavës, neni 6) pasi ekziston një trend në rritje, bazuar në vendimet e gjykatave, të cilat vit pas viti kanë shtuar numrin e pasurive, të cilat i kalojnë në administrim AAPSK.
2. Të krijohet një zyre qendrore kombëtare si nevojë e administrimit të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara, e cila vjen edhe si një detyrim sipas të cilit shtetet anëtare që i nënshtrohen vlerësimit të MONEYVAL, duhet të krijojnë një zyrë qendrore kombëtare të administrimit të pasurive, si nevojë për të administruar pasuritë "e vështira", për shembull gjëja e gjallë, kompanitë, fondet e besimit dhe pasuritë e paluajtshme hipotekore, qoftë për rastet e brendshme ose pasi kërkesa e juridiksioneve të huaja është rritur.
3. Të shtohen kompetencat e AAPSK-së sipas rekomandimeve të MONEYVAL.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: – status quo-ja

Opsioni 1: – miratimi i një ligji të ri si bazë ligjore.

Opsioni 2: ndryshimi i ligjit aktual

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

miratimi i një projektligji për administrimin pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara” në radhë të parë, do të ngrejë në një nivel më të lartë të gjithë procesin aktual të administrimit të pasurive, duke vendosur në themele ligjore procedurën që ndjek Agjencia, që nga momenti i parë i ekzekutimit të Vendimit të sekuestros, me marrjen në dorëzim të pasurive që do të administrohen, duke vijuar më pas me menaxhimin e tyre, sipas mënyrave dhe formave specifike në varësi të llojit të pasurisë, e duke mbyllur qarkun e administrimit, me anë të procesit të destinimit përfundimtar të pasurive që konfiskohen.

Gjithashtu shtimi i kompetencës për shitjen e pasurive të luajtshme, të cilat prishen, amortizohen apo u bie vlera shpejt, qysh në fazën e sekuestrimit, duke mos pritur vendimin përfundimtar të konfiskimit, do të bënte që vlera e realizuar nga shitja e pasurisë të ruhej në një llogari bankare të veçantë, e në rast revokimi të sekuestrimit t’i kthehej pronarit të

ligjshëm, ndërsa në rast konfiskimi të kalonte në buxhetin e shtetit. Shitja e parakohshme e këtyre pasurive të sekuestruara do të sillte një përfitim për të gjithë, pasi jo vetëm ruhet vlera momentale e pasurisë së luajtshme (autoveturë, pajisje teknologjike dhe IT, gjë e gjallë, etj), vlerë e cila do të humbte fare, në qoftë se këto pasuri do të mbaheshin deri në përfundim të afateve procedurale gjyqësore, por edhe shkurton ndjeshëm shpenzimet e Agjencisë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është opsioni nr. 1, miratimi i një ligji të ri si bazë ligjore, kjo pasi organizimi dhe funksionimi i AAPSK-së nuk ka qënë më parë i rregulluar me akt ligjor dhe vetëm kështu mund të bëhet e mundur zgjidhja e problemit dhe arritja e objektivave të synuara.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

-Zeri paga dhe sigurime shoqerore planifikohet me rritje krahasuar me te pritshmin 2018 ne shumen 13.000 leke (e shprehur ne 000/lek) pasi ne strukturen e planifikuar kemi rritje te numrit të stafit te AAPSK-së nga 8 në 19 punonjës.

-Shpenzimet operative jane te planifikuara te njejta edhe per vitet ne vazhdim, ndersa per investimet mendojme se duhet te planifikohen per vitet 2020 ne shumen 6,000 leke, kjo per aresye se shtesa e planifikuar ne Strukture (11 punonjes) burime njerezore, duhet te shoqerohet me blerje paisje per zyra dhe mjete pune.

Planifikimi ne Buxhet ne mijera leke/000

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Totali 31,000	Totali 25,000	Totali 25,000

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji eshte publikuar per konsultim ne rregjistrin e konsultimeve dhe ne faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk ka pasur asnje reagim nga asnjë palët e interesuara.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Institucionet e ngarkuara për zbatimin dhe monitorimin e këtij projektligji do të jenë Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara, si dhe pas miratimit të këtij Projektligji do të dalin dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Deri tani nuk ka pasur një rregullim ligjor për të bërë të mundur organizimin dhe funksionimin e AAPSK. Të gjitha pasuritë e konfiskuara dhe sekuestruara janë administruar duke pasur parasysh vendimin nr. 687 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara”. Gjithashtu AAPSK gjatë punës së saj ka pasur parasysh edhe parashikimet e ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimet e tjera ndërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar. Për këtë arsye ka lindur nevoja e pasjes së një ligji, i cili do të bëjë të mundur mirëfunksionimin e Agjencisë dhe do të lehtësojë punën për mirëadministrimin e pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara.

Ligji “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara” synon, në radhë të parë, të cojë në një nivel më të lartë të gjithë procesin aktual të administrimit të pasurive, duke vendosur në themele ligjore procedurën që ndjek Agjencia, që nga momenti i parë i ekzekutimit të vendimit të sekuestros, me marrjen në dorëzim të pasurive që do të administrohen, duke vijuar më pas me menaxhimin e tyre, sipas mënyrave dhe formave specifike në varësi të llojit të pasurisë, e duke mbyllur qarkun e administrimit, me anë të procesit të destinimit përfundimtar të pasurive që konfiskohen.

Synim tjetër i rëndësishëm, i cili përmbush një rekomandim të rëndësishëm të konventës së Varshavës, neni 6 dhe UNCAC neni 60, është edhe shtimi i kompetencës për shitjen e pasurive të luajtshme, të cilat prishen, amortizohen apo u bie vlera shpejt, qysh në fazën e sekuestrimit, duke mos pritur vendimin përfundimtar të konfiskimit. Përdorimi i kësaj procedure do të bënte që vlera e realizuar nga shitja e pasurisë të ruhej në një llogari bankare të veçantë, e në rast revokimi të sekuestrimit t’i kthehej pronarit të ligjshëm, ndërsa në rast konfiskimi të kalonte në buxhetin e shtetit. Shitja e parakohshme e këtyre pasurive të sekuestruara do të sillte një përfitim për të gjithë, pasi jo vetëm ruhet vlera momentale e pasurisë së luajtshme (autoveturë, pajisje teknologjike dhe IT, gjë e gjallë, etj), vlerë e cila do të humbte fare, në qoftë se këto pasuri do të mbaheshin deri në përfundim të afateve procedurale gjyqësore, por edhe shkurton ndjeshëm shpenzimet e Agjencisë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Së fundmi, synohet që ky të shërbejë edhe si ligj organik për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke përcaktuar me norma ligjore organizimin, funksionet dhe kompetencat e saj.

Nënvizojmë gjithashtu faktin se në të gjitha Raportet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit është venë theksi gjithmonë e më shpesh në “Fuqizimin

dhe Përmirësimin e strukturës së AAPSK-së”. Po ashtu vlerësimi i 4-t i MONEYVAL, si dhe Plani për zbatimin e rekomandimeve të lëna pas këtij vlerësimi (IO.8, pika V), kanë përcaktuar qartë nevojën për shtimin e kompetencave të AAPSK-së, duke përfshirë brenda saj administrimin e të gjitha pasurive me prejardhje kriminale.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Ashtu si me shumë aspekte të procesit të rikuperimit të pasurive, Shqipëria ka një strukturë të mirë lidhur me administrimin e pasurive, megjithëse nevojiten zhvillime të mëtejshme për të maksimizuar ekzistencën e AAPSK-së dhe për ta shfrytëzuar plotësisht këtë burim, në përputhje me praktikën më të mira.

Çështja e administrimit të pasurive është diskutuar shumë në forumet ndërkombëtare dhe rajonale. Standardet përkatëse ndërkombëtare theksojnë se juridiksionet duhet të kenë mekanizma ligjore për të menaxhuar në mënyrë efektive pasurit e ngrira dhe të konfiskuara, në pritje të një vendimi të formës së prerë. (UNCAC, neni 60, Konventa e Varshavës, neni 6). Nuk ka grupe të cilat do të preken nga ky projektligj.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është një agjenci administrative e ngritur në kuadër të Ministrisë së Financave. Rregullimi i deritanishëm i saj është bërë me akt nënligjor. Funksioni i saj kryesor është administrimi i pasurive pas sekuestrimit deri në kthimin e tyre ose konfiskimin përfundimtar, sipas vendimeve të gjykatës.

Strukturat e zbatimit të ligjit dhe prokurorët shqiptarë, si dhe vlerësuesit e jashtëm, këtu kemi parasysh konventën e Varshavës, neni 6 dhe UNCAC neni 60, kanë raportuar një nivel të lartë të konfuzionit të roleve dhe strukturave brenda procesit të konfiskimit të pasurisë në Shqipëri. Përqendrimi i administrimit të të gjitha pasurive do ta lehtësonte këtë nga pikëpamja e administrimit të pasurive. Ngritja e rregullimit të organizimit të këtij institucioni në nivelin ligjor do të sillte një qendrueshmëri të AAPSK duke bërë kështu të mundur mirëadministrimin e pasurive. Gjithashtu, bëhet i mundur lejimi i stafit brenda AAPSK-së të ndërtojë nivelin e ekspertizës për të qenë plotësisht efektiv.

Me miratimin e këtij projektligji synohen të arrihet zgjidhja e të gjitha problematikave të cilat kanë dalë gjatë punës së Agjencisë.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 - *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
1. Të krijohen mekanizmat ligjor për të menaxhuar në mënyrë efektive pasuritë e ngrira dhe të konfiskuara, në pritje të një vendimi të formës së prerë. (UNCAC, neni 60, Konventa e Varshavës, neni 6), pasi ekziston një trend në rritje, bazuar në vendimet e gjykatave të cilat vit pas viti kanë shtuar numrin e pasurive të cilat i kalojnë në administrim AAPSK.
 2. Të krijohet një zyrë qendrore kombëtare si nevojë e administrimit të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara, e cila vjen edhe si një detyrim sipas të cilit shtetet anëtare të cilat i nënshtrohen vlerësimit të MONEYVAL, duhet të krijojnë një zyrë qendrore kombëtare të administrimit të pasurive si nevojë për të administruar pasuritë "e vështira", për shembull gjeja e gjallë, kompanitë, fondet e besimit dhe pasuritë e paluajtshme hipotekore, qoftë për rastet e brendshme ose pasi kërkesa e juridiksioneve të huaja është rritur.
 3. Të shtohen kompetencat e AAPSK-së sipas rekomandimeve të MONEYVAL.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni – status quo

Legjislacioni ekzistues lejon AAPSK të administrojë kryesisht asetet e sekuestruara apo të konfiskuara sipas ligjit 10192/2009 i ndryshuar, por nuk i jep mundësinë që AAPSK të administrojë të gjitha asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara qoftë civile dhe penale, për të qenë plotësisht efektiv, pasi Gjykatat e Rretheve Gjyqesore nuk janë të detyruara t'ia kalojnë AAPSK-se për administrim, pasuritë që sekuestrohen /konfiskohen gjatë procesit penal, që ato zhvillojnë, pasi mungon parashikimi me ligj.

Opsioni 1 (preferuar) – miratimi i një ligji të ri si bazë ligjore

Opsioni nr. 1 ngelet e vetmja mundësi për të arritur objektivat e vendosura dhe për të zgjidhur problemet e identifikuara.

Opsioni 2 – Ndryshimi i ligjit aktual, ky opsion është i pazbatueshëm pasi AAPSK rregullohej me akt nënligjor.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*

- o *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - o *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - o *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - o *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - o *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - o *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
 - *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - o *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Ndikimet ekonomike

- Ky është një propozim shpenzimi. Miratimi i një ligji të ri për AAPSK-ne do të kërkojë fonde shtesë nga buxheti i shtetit për vitin 2019 dhe në vazhdim. Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik do të përbëjnë kërkesa për fonde shtesë në buxhetin e shtetit për të mundësuar zbatimin e propozimeve të projektaktit.
- Fondet për kryerjen e veprimtarisë së Agjencisë do të financohen nga Buxheti i Shtetit (Për punonjësit e rekrutuar nepermes DAP-it të cilat kanë statusin e Nepunest Civil) ndërsa të ardhurat e tjera të krijuara nga burime të ligjshme, si Sekuestrimi/Konfiskimi i pasurive duke përfshirë: të ardhurat e krijuara nga objektet e dhena me qira, konfiskimi i llogarive dhe derdhja e tyre në Buxhet, do të shërbejnë për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për pjesën tjetër të stafit (Administratoret).
- Miratimi i strukturës së re, të propozuar nga AAPSK-ja e cila është pasqyruar në relacionin që shoqëron projekt ligjin e ri, ben të domosdoshme zgjerimin me zyra të reja pasi është parashikuar një shtesë prej 11 punonjësish në organike. Zyrat aktuale nuk mund të përballojnë shtesën e punonjësve të rinj, prandaj kërkohej që AAPSK-ja të vendoset në ambiente të tjera zyrash që plotësojnë nevojat e reja në burime njerezore.

Per kete qellim kerkohet qe ne planin afat mesem 2019-2020, te buxhetohen **6,000 (në /000 lekë)**per paisje zyrash si kompjutera, tavolina pune etj. Njekohësisht kerkohet qe ne shumen e investime te sipercituar, te perfshihet edhe blerja e nje automjeti te ri, kjo me arsyetimin se rritja e volumit te punes si rezultat i marrjes ne dorezim te pronave te sek/konf do te shoqerohet edhe me rritjen e administratoreve dhe mjeti aktual qe ka ne perdorim AAPSK-ja eshte i vjeter 20 vjecar dhe nuk eshte i mjaftueshem per te perballuar volumin e

ne rritje te punes . Aktualisht ne planin e investimeve te vitit 2019 AAPSK-ja ka planifikuar në masën 6.000 (ne/000 leke) dhe për vitin 2020-2021, nuk ka te planifikuar investime. Ne vitin 2018, investimet ishin ne vleren 1,500 leke (ne /000 leke). Miratimi i projekt ligjit te ri do te beje te mundur qe AAPSK-ja te mbuloje edhe statistikat e unifikuara me institucionet e tjera bashkëpunuese, në lidhje me procesin dhe ecurinë e pasurive te sekuestruara dhe konfiskuara, kjo do te behet ne përmes nje programi i cili eshte ne përfundim nga AKSHI. Ky program eshte planifikuar te financohet plotesisht nga Buxheti i Shtetit, ku AAPSK-ja eshte perfituesja e drejtperdrejte.

Propozimi gjithashtu ka gjasa të sjellë përfitime të drejtpërdrejta ekonomike për sektorin publik, shoqërinë dhe ekonominë e gjerë. Miratimi i projekt ligjit te ri do ti jape AAPSK-se kompetenca me te gjera ne fushen e mireadministrimit e pasurive te Sek/konf. dhe jo vetem ne kuadrin e ligjit te Antimafies, por edhe te vendimeve qe marrin gjykatat ne shkalle vendi per ceshtje civile dhe penale. Kjo arrihet edhe ne saje te pervojës se menaxhimit te pronave te sek/konf, te krijuar nga stafi i AAPSK-se ne vite, si institucion i specializuar ne kete fushe. Kjo do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së punës dhe efikasitetit të shpenzimeve publike.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është **Opsioni 1**. Opsioni 1 do të sigurojë bazën ligjore, e cila dote heqë çdo pengese ligjore dhe procedurale, qe pengon AAPSK-ne te administroje te gjitha pasurite e sekuestruara/konfiskuara civile apo penale, për te qene plotësisht efektiv. Gjithashtu me miratimin e këtij ligji do të përmbushet edhe rekomandimi i lënë nga MONEYVAL.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Agjencia e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara ngarkohet me përgjegjësinë e zbatimit të Ligjit “Për Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara”.

Hartimi i akteve nënligjore, të parashikuara me ligj, do të bëjnë të mundur zbatimin e ligjit.

Projektligji do të autorizojë miratimin e vendimeve të caktuara të Këshillit të Ministrave, të cilat do të mundësojnë zbatimin e tij nga institucionet zbatuese të vartësisë.

Ministria përgjegjëse do të monitorojë zbatimin e Ligjit “Për Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara”.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/trequesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit-n do të bëhet e mundur përgatitja e nje programi me ane se cilit do të raportohen statistikat lidhur me miradministrimin e pasurive. Të dhënat mbi pasuritë e konfiskuara dhe sekuestruara do të shihen në kohë rekord dhe gjendja e tyre do të jetë në kohë reale.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

[illegible][illegible]

Vlera aktuale e koston në total	
Vlera aktuale e përfitimit në total	
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total	

Në tabelën e mësipërme është plotësuar kostoja shtesë për buxhetin e shtetit që rrjedh nga rishikimi i projektligjit. Konkreisht për vitin e parë që është supozuar viti 2019, kosto për buxhetin vetëm njëherë është kostoja e investimit për pajisjes prej 6 000 mijë lekësh ndërkohë që kosto e vijueshme do të jetë kostoja e shpenzimeve të personelit të shtuar prej 12.8 milionë lekë më shumë se sa fondi aktual i miratuar për strukturën e miratuar të AAPSK. Kjo kosto do të planifikohet në Programin Buxhetor Afatmesëm për vitet 2020-2022 për të mundësuar garantimin e fondeve për të përballuar ndryshimet e propozuara strukturore.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			